



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

KRYETARI I KRYEQYTETIT
11-016/01-127704/24, më 27 SEP 2024

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008) dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, merr këtë:

V E N D I M

1. **Lirohen** nga pagesa e Trafikut Urban invalidët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga Komuna e Prishtinës.
2. Lirimi nga pagesa do të bëhet nga data 1.10.2024.
3. Obligohen organet drejtuese të NPL "Trafiku Urban" SH.A që në bashkëpunim me Shoqatën e Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – Dega Prishtinë, t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe fillon të zbatohet nga data e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

Arsyetim

Ky vendim nxjerrët sipas kërkesës së Shoqatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – Dega Prishtinë, si mbështetje institucionale për këtë kategori të merituar të luftës tonë çlirimtare.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama



U DORËZOHET:

- Kryeshefit dhe organeve drejtuese të NPL "Trafiku Urban";
- Shoqatës së Invalidëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – Dega Prishtinë;
- Qendrës për shërbime me qytetarë; dhe
- Në dosje.